



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Nr. ____ Prot.,

Tiranë më ____ 2019

Lënda:

Propozim amendament nen për nen për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, 24 orë përpara seancës plenare.

DREJTUAR:

**Z. Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT**

K Ë T U

BAZA LIGJORE:

Rregullorja e Kuvendit, neni 75

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 75, pikat 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, paraqes amendamentin si më poshtë në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

Neni 17, pika Pika 4 i projektligjit të ndryshojë si më poshtë:

“Drejtuesit e institucioneve të kujdesit shëndetësor publik përzgjidhen mes profesionistëve të shëndetit, me përvojë pune në sistemin shëndetësor dhe emërohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas procedurës së përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë”.

DEPUTETI PROPOZUES:

Enver Roshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

Lënda: Amendament

Zotit Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar Z. Ruçi,

Mbështetur në nenin 75 pika 4 të Rregullores së Kuvendit propozoj që në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. **Në nenin 1 të projektligjit**, që ndryshon nenit 3 të ligjit, pika 16 të hiqet.
2. **Në nenin 17 të projektligjit**, që shton nenin 31/1 në ligj, të bëhen ndryshimet si vijon:
 - a. pika 2 të riformulohet:

“2. Profesionistët e shëndetësisë pranojnë në institucionet e kujdesit shëndetësor publik bazuar në kriteret dhe procedurat e konkurrimit, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.”
 - b. Pika 3 të hiqet.
3. **Neni 22** të riformulohet si vijon:

“Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”, me përjashtim të nenit 12 i cili hyn në fuqi në datën 1 korrik 2020 dhe nenit 15, pika 5, e cila hyn në fuqi në datën 1 janar 2021.”

Deputet

Ilir BEQAJ

RELACION

Ligji për “Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” rregullon funksionimin e të gjithë sistemit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Si i tillë, është e pavend që në të njëjtin ligj të përcaktohen instrumente që përdor qeveria si punëdhënës në kujdesin shëndetësor publik.

Shfrytëzimi i portaleve si instrumente për një punësim sa më të efektshëm dhe transparent në sistemin publik nuk ka pse të vendoset në ligj. Në të ardhmen qeveria mund të vendosë të përdorë instrumente deri më sot të panjohur dhe për këtë do të duhet të bëjmë ndryshimet përkatëse ligjore. Prandaj propozohet që instrumente të ngjashëm me portalin të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Data 1 janar 2020 është e parakohshme për të filluar zbatimin e auditit klinik si dhe shtrirjen e shëndetësisë elektronike në sektorin jopublik të kujdesit shëndetësor. Do të duhet të dalin vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe më tej qoftë të njihen ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe për më tepër do të kenë nevojë për kohë të mjaftueshme për të bërë investimet dhe përshtatjet dhe nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore.

Prandaj propozohet që detyrimet e auditit klinik të fillojnë nga 1 korrik 2020 dhe detyrimet e shëndetësisë elektronike në sistemin jopublik të fillojnë në 1 janar 2021.


Deputet
Ilir BEQAJ